



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan  
D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319

E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023  
Nr. Dok. 202300663/1

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Durrës.

**Drejtuar:** Skënder HITAJ  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

**DURRËS**

**Komisariatit të Policisë Durrës**

**DURRËS**

**Për dijeni:** Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

**TIRANË**

*Të nderuar zotërinj,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Durrës.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë në Durrës, në datën 17.07.2023, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, me detyrë Nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e rendit në këtë komisariat z. Kastriot Stafhasani në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë Vendore dhe Shefit të Komisarariatit Durrës.

Në vijim, shefi i rendit informoi grupin e inspektimit, për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisariat, trajtimin sipas të drejtave ligjore që gëzojnë personat e privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se<sup>1</sup>:

1. Nuk ishin marrë masat për krijimin më vete të dhomës të intervistimit të personave të shoqëruar dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit audio-viziv në këto dhoma.
2. Nuk ishin marrë masat për pajisjen e ambientit të shoqërimit me dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra.

---

<sup>1</sup> Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Durrës. K4/I84-2 , Nr. Doc 202201416, Dt.12.12.2022.

3. Nuk ishin marrë masat për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
4. Nuk ishin marrë masat për mirëmbajtjen e dhomave të arrestimit/ ndalimit si: lysterjen e tyre, zëvendësimin me pajisje të reja për fjetje (dyshekë, batanije).
5. Marrjen e masave për rritjen e higjienës në dhomat e shoqërimit dhe ndalimit në ambientet e Komisarariatit të policisë Durrës.
6. Në lidhje me rekomandimin për nxjerrjen e përgjegjësive për mos garantimin e kushteve dinjitoze për personat e shoqëruar apo ndaluar, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës me shkresën kthim përgjigje nr. 12277/1Prot, dt.17.01.2023, na bën me dije se kjo vjen si pasojë e mungesës së investimeve në këto ambiente e cila nuk është në kompetencën e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës për tu realizuar, dhe nisur nga ky fakt i është kërkuar mbështetje me shkresën Nr.181 datë 09.01.2023, departamentit të shërbimeve mbështetëse, drejtorisë së mbështetjes logjistike për kërkesat e trajtuara në rekomandime.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

- ✓ Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave personave të shoqëruar apo ndaluar në momentin e hyrjes së tyre në komisarariat.
- ✓ Marrjen e masave për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të afishuara në dhomat e shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta.

Në përfundim të inspektimit, në mjedisin e shoqërimit dhe atë të sigurisë në Komisarariatit e Policisë Durrës, grupi inspektues konstatoi se, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, të cilat i parashtrijmë si më poshtë vijon.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarariatit e Policisë Durrës, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar pjesërisht sipas kushteve dhe kriterëve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në*

*mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit<sup>23</sup>.

Ambienti i shoqërimit përbëhet nga 4 (katër) dhoma shoqërimi të ndara më vete 2 (dy) dhoma për mbajtjen dhe trajtimin e personave të rritur, 1 (një) dhomë për gra dhe 1 (një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 5x3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve me kapacitet deri 15 persona, me kushte normale për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që iu njeh ligji këtyre personave.

Problemet e konstatuara në dhomat e shoqërimit lidhen me mungesën e mirëmbajtjes, konkretisht muret të cilat ishin dukshëm të palyera dhe dhomat ishin në kushte higjieno sanitare jo të mira. Një gjendje e tillë është faktor i shtuar për trajtim jo dinjitoz të personave të shoqëruar.

Dritaret në dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me skarë hekuri që lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, ndërkohë dhomat kishin ndriçim edhe nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pajisura me stola druri me skelete metalike të fiksuara në dysheme për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet i përbashkët për meshkuj dhe femra, pajisur me lavaman dhe çezmë me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Ndërkohë, sipas procedurave standarde, ambienti i shoqërimit duhet të ketë dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra.

---

<sup>2</sup> *Kreu VII, pika 4 “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr.938, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

<sup>3</sup> Kushtet e mbajtjes dhe Siguria për personat e shoqëruar

Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre, si më poshtë :

a. Personat e shoqëruar mbahen në mjedise e ambiente me kushte të ndryshme nga ato që shërbejnë për mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar (dhomat e sigurisë).

b. Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur. Këto mjedise të jenë brenda ndërtesave të drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë.

c. Mjediset të jenë me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin e personave të jenë të lyera, të pastra nga higjienike si dhe të kenë dritare me përmasa të tilla që të krijojnë mundësi për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral.

d. Në mjediset ku pyetet i shoqëruari të kenë të vendosura pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si; tavolina e karrige si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme.

e. Brenda këtyre ambienteve ose ngjitur me to, të ketë tualete, të ndara për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

f. Në të gjitha mjediset të mos mbahen sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

g. Dritaret e këtyre mjedisëve të jenë të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.

Në mjedisin dhe korridorin e shoqërimit, ishin të instaluara kamera për monitorimin e veprimeve që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar përgjatë 24 orëve.

Gjatë inspektimi u evidentua se situata me njohjen e të drejtave ishte përmirësuar dukshëm në këtë komisariat, në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, gjithashtu ishin të afishuar edhe brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta. Të shoqëruarit e kanë të pamundur ti konsultojnë këto të drejta nëse ato janë në korridor, edhe pse koha e qëndrimit të tyre në korridor është e vogël vetëm kur kalojnë.

Në momentin e inspektimit kishte një shtetas të shoqëruar, për muajin qershor 2023, ishin shoqëruar për në mjediset e këtij komisariati 183 persona nga këta 71 persona të mitur dhe 26 gra.

Nga komunikimi me punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit, konstatoam se **personave të shoqëruar ju jepej një kopje e kartës me të drejtat e tyre në momentin që ata hynin në dhomat e shoqërimit.** Në ditën e inspektimit në dhomën e shoqërimit ndodhej një person i cili përgjatë bisedës me ekipin e Avokatit të Popullit konfirmoi se ishte pajisur me kartën e të drejtave që në momentin e parë të hyrjes në komisariat dhe ishte i qartë në lidhje me të drejtat e tij.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me “kartën e të drejtave” në rast shoqërimi në polici, “Karta e të Drejtave” është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Në këtë “Kartë” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të Policisë kundrejt tij.

“Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit por edhe vetë Policisë së Shtetit, për rritur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një strukturave profesionale shërbyese dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e Policisë.

Në ambientin e shoqërimit ndodhej dhoma për marrjen e shenjave të gishtave të këtyre personave, me qëllim identifikimin në kohë dhe të saktë të personit, por nuk kishte një dhomë më vete për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë, zyrat e punës të të cilëve, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave. Sa më sipër është në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109 paragrafi 5<sup>4</sup> dhe 122 paragrafi 5<sup>5</sup> e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4<sup>6</sup> të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Gjithashtu, u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Durrës, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, grupi i inspektimit nuk konstatoi në ambientin e shoqërimit, sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisaratin e Policisë Durrës, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar pjesërisht sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurën standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Në këtë ambient ndodheshin 8 (tetë) dhoma sigurie, nga të cilat 6 (gjashtë) për meshkuj madhorë, 1 (një) për gra dhe 1 (një) për të mitur. Kapaciteti zyrtar i dhomave të sigurisë ishte për trajtimin dhe sigurimin e 8 (tetë) personave të arrestuar/ndaluar. Në ditën e

---

<sup>4</sup> Neni 129 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: “Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”

<sup>5</sup> Neni 122 paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: “Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.”

<sup>6</sup>Urdhër, nr. 938 datë 24.07.2019 “Procedura standarde e punës për: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

inspektimit grupi i monitorimit konstatoi se, në dhoma ishin akomoduar 4 persona, koha e qëndrimit të tyre në këto ambiente ishte 1-2 ditë<sup>7</sup>.

Nga këqyrja e këtyre regjistrave për vitin 2023 numri total i arrestim/ ndalimeve në këtë komisariat ishte 434 persona. Në Komisarlatin e Policisë Durrës, akomodohen dhe personat e ndaluar/arrestuar nga komisarlatet e policisë të Krujës dhe të Shijakut, në varësi të DVP Durrës.

Nga intervistat me personat e ndaluar/arrestuar, rezultoi se koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë të personave me masë sigurie “arrest me burg”, sipas urdhrin të lëshuar nga organi i prokurorisë, ishte deri në 96 orë brenda afati ligjor maksimal për vleftësimin e masës të sigurisë nga ana e gjykatës.

Gjatë inspektimit, u evidentua se në dhomat e sigurisë mundësohej ndriçimi natyral dhe artificial i mjaftueshëm. Në Komisarlatin e Policisë Durrës nuk kishte ambiente për të dalë në ajrim duke bërë që këto kushte të mos ofrojnë trajtim me dinjitet të personave që kalojnë midis 48 orë në 4-5 ditë në këto ambiente.

Në çdo dhomë ishin instaluar zile për komunikimin e personave të ndaluar apo arrestuar me personelin e shërbimit në rast nevojë. Nga biseda me përgjegjës të dhomave në ambientet e sigurisë konstatoam se zyra e punonjësit të shërbimit ishte pajisur me aparat telefonik, për t’u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Disa nga problemet e konstatuara lidhen me mirëmbajtjen e munguar të ambienteve, të cilat ishin dukshëm të palyera, gjithashtu, konstatohet një amortizim i lartë i pajisjeve për fjetje (dyshekë, batanije, çarçafë, etj.), duke mos plotësuar kërkesat minimale dhe standardet, që kërkojnë respektimin e dinjitetit të personave të shoqëruar dhe arrestuar, ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor, ashtu sikundër përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Policisë së Shtetit. Përgjatë inspektimit konstatoam se dhoma 8 në ambientin e sigurisë kishte lagështirë të theksuar.

Lidhur me këtë situatë të përsëritur Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se qëndrimi i shtetasve për ditë në dhomë në batanije të papastra, murre me lagështirë të theksuar dhe në mungesë të përgjithshme mirëmbajtje të higjienës, përbën trajtim jo dinjitoz të tyre në shkelje të Urdhrit nr. 925, datë 18.07. 2019, “Trajtimi dhe sigurimi i personave

---

<sup>7</sup> Gjatë vizitës inspektuese të CPT (Evropian Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës) në Shqipëri në vitin 2018, raport i të cilit është botuar në vitin 2019. Në rekomandimin 8 të këtij raporti theksohet se, dhomat e sigurisë në komisarlatet e policisë duhet të sigurojnë një sipërfaqe prej 6-8 m2 vetëm për një person. Ndërkohë, që në përgjigjen e Qeverisë Shqiptare për këtë rekomandim, theksohet se, nuk ka persona të arrestuar/ndaluar, që mbahen në dhoma më pak se 5m2 dhe në dimensione 5-8m2, më shumë se një person.

të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Në kapitullin V “Rregullat dhe Procedurat për Pranimin, Regjistrimin Kontrollin, Transferimin dhe Lirimin e të Arrestuarve/Ndaluarve”, pika 9.3 parashikon se *“Kur konstatohen mangësi të kushteve të sigurisë, apo kur kushtet higjienike nuk përmbushin standardet e kërkuara dhe përcaktuara në këtë procedure, i arrestuari/ndaluari futet/akomodohet në dhomë tjetër e cila plotëson kushtet, si dhe njoftohet eprori direkt dhe merren masat për eliminimin e mangësive.”*

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me tualete, në paradhoma ishin instaluar çezma për larje e pastrim vetjak të personave të ndaluar/arrestuar. Ndërsa për larjen e trupit, kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë) i cili ndodhej në korridorin e dhomave të sigurisë. Gjithashtu, në ambientet e sigurisë kishte sistem ngrohjeje me kaldajë për periudhën e dimrit.

Ekspertët e MKPT- së të Institucionit të Avokatit të Popullit, e kanë evidentuar edhe më parë këtë situatë gjithashtu edhe janë bërë në rekomandimet përkatëse, por vërejmë se, ndryshimet në mirëmbajtjen e dhomave janë të pakta dhe të pamjaftueshme, krahasuar me problematikën që ekziston në dhomat e sigurisë, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë. Një gjendje e tillë është faktor i shtuar për rrezikun shëndetësor.

Në ambientin e sigurisë ndodhej dhoma për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige si dhe me frigorifer për ruajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat kërkojnë të mbahen në kushte frigoriferike. Në një raft, mbaheshin kartelat mjekësore me dinamikën e vizitave mjekësore për çdo person të ndaluar/arrestuar. Nga këqyrja e regjistrimit të mjekut vërejmë se ishte plotësuar në çdo rubrikë për evidentimin e të dhënave shëndetësore për personat që ju privohet liria në ambientet e këtij komisariati.

Në këtë ambient ndodhej një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët, e cila shërbente dhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave që merren në pyetje, por nuk kishte kamera për mbajtjen në vëzhgim të veprimeve që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore me të ndaluarit/arrestuarit dhe anasjelltas për të parandaluar çdo veprim të mundshëm të këtyre personave.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me kamera për 24 orë.

**Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e sigurisë,**



Në kohën e inspektimit, në ambientet e sigurisë ndodheshin 4 persona të ndaluar/arrestuar, në pritje të vlerësimit të masave të sigurisë nga gjykata.

Nga intervistat që zhvilloi grupi i inspektimit me personat e ndaluar/arrestuar, u konstatua se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte nga punonjësit e shërbimit të dhomave të sigurisë, si dhe gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Trajtimi i tyre ishte përgjithësisht brenda standardit dhe ata nuk ankoreshin për trajtim denigrues apo jo humane, si dhe ndaj tyre nuk ushtrohej dhune fizike e psikologjike. Të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë. Ushqimi dhe gatimi i tij sigurohej dhe shërbehej me katering, nga subjektet private.

Nga biseda me personat e arrestuar në këto ambiente ankesat kryesore ishin për mungesën e higjienës gjithashtu dhe për mungesën e ajrimit.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Nga inspektimi rezultoi se, regjistrat ishin të mbajtur në rregull, ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë, Durrës, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform me procedurat standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Ndërkohë, **përgjatë këqyrjes së këtij regjistri konstatuam se rubrika e regjistrit mbi njoftimin e familjarëve nuk ishte e plotësuar në mënyrë korrekte**, pasi në regjistër nuk ishte i shënuar emri i familjarit të njoftuar me numrin e telefonit përkatës, por ishte shënuar nga specialisti i policisë vetëm “njoftuar familjari” e cila nuk identifikon familjarin i

cili ka marrë djeni<sup>8</sup>, kjo bazuar në Urdhrin, nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit e përcaktuar në “Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit ” ku në pikën a.1.2 citohet se: Regjistri i Evidentimit të Personave të Shoqëruar: Të dhënat për realizimin e të drejtës për njoftimin e familjarëve/afërmve për shoqërimin si: emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar për faktin e shoqërimit dhe të vend ndodhjes së personit të shoqëruar, si dhe orën e njoftimit.

Në këtë komisariat ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë. Kjo situatë, u verifikua edhe për personat e ndaluar apo të arrestuar nga komisariatet e policisë Shijak dhe Krujë , të cilët në përfundim të procedurave ligjore të kryera nga specialistët e krimeve, dërgohen në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Durrës.

Avokatit të Popullit, ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vihet ora e mbikëqyrjes policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe neni 109, pika 4 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, në zyrën e informacionit ndodhej dhe regjistri për evidentimin e të dhënave për personat e shoqëruar të mitur. Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, për periudhën që kryhej inspektimi, ishin të evidentuara vetëm kërkesa.

---

<sup>8</sup> *Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë: dhënien e informacionit të të shoqëruarve për të drejtat e tyre; sigurimin e aksesit të një avokati; njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin.*

Në Komisarlatin e Policisë Durrës, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Durrës specialistët e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera për vëzhgimin e veprimeve procedurale të kryera nga ana e punonjësve të policisë.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit në vijimësi i ka rekomanduar organeve të Policisë së Shtetit marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse përmendëm edhe më lart, ky rekomandim nuk është zbatuar ende në këtë Komisarlat.

Po ashtu, edhe dhoma për marrjen në pyetje të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore që ndodhej në dhomat e sigurisë, nuk ishte me kushte të përshtatshme pune (shërbente dhe për takime me avokatët), si dhe nuk kishte të instaluar sistemin e kamerave.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare<sup>9</sup>, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Nga monitorimi që u bë në zyrat e punonjësve të policisë që ndodheshin në kohën e inspektimit në këtë Komisarlat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Avokati i Popullit ka pasur në trajtim disa ankesa nga qytetarët të cilët kanë patur pretendimin për ushtrim

---

<sup>9</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

force në këtë komisariat. Ndaj plotësimi i standardeve merr rëndësi të madhe, veçanërisht në funksion të masave parandaluese.

### **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të arrestuarit/ndaluarit ishin të mitur, kryerja e veprimeve procedurale bëhej nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dhe në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i Prokurorisë Durrës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, e cila ishte e afishuar në ambiente të dukshme dhe të aksesueshme. Ndërsa psikologu ishte në organikë të DVP Durrës.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në ambientin e sigurisë të këtij Komisarati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë, por ato nuk ishin të vendosur në ambientet brenda dhomave ku qëndrojnë këta persona, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme nga ana e tyre.

U konstatua se në këtë Komisarati zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi;

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin më vete të dhomës të intervistimit të personave të shoqëruar dhe të dhomës për marrjen në pyetje të personave të

arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit audio-viziv në këto dhoma.

2. Marrjen e masave për plotësimin me korrektësi rubrikën njoftimi i familjarëve tek Regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër.
3. Marrjen e masave për pajisjen e ambientit të shoqërimit me dy tualete të ndara më vete për meshkuj dhe femra.
4. Marrjen e masave për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit, higjienizimin dhe lyerjen e tyre.
5. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të ajrimit për personat në dhomat e sigurisë.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për mirëmbajtjen e dhomave arrestimit/ndalimit si: lyerjen e tyre, zëvendësimin e stolave si dhe pajisjen e dhomave të sigurisë me pajisje të reja për fjetje (dyshekë, batanije).
7. Marrjen e masave për realizimin e trajnimeve të vazhdueshme për zbatimin e të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të detyrave.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ahmet Prençi**